



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ 1319 / 2026
Data 09.02.2026

Në bazë të Rregullorës për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.01/8214/2024 të datës 04.10.2024 neni 14 pika 14.1.1 dhe neni 15, Drejtoria Komunale për Arsim shpallë këtë:

THIRRJE PUBLIKE
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENT/E TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Kushtet për aplikim;

- a) Të jenë banorë të Komunës së Hanit të Elezit;
- b) Të jenë student/e të Universitetit Publik të Kosovës;
- c) Të jenë student/e të Universitetit Publik të Maqedonisë Veriore;
- d) Të jenë student/e të rregullt, por jo me vetëfinancim;
- e) Të kenë të regjistruar vitin;
- f) Studenti/ja nëse një herë ka përsëritur vitin, humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet);
- g) Studenti/ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë;
- h) Studenti/ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursë;

Prioritetet për kuadro deficitare janë Fakultetet:

- a) **Fakulteti i Mjekësisë** (Mjekësi e Përgjithshme, stomatologji, farmaci).
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Konstruksioneve, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së Ambientit, Arkitekturë dhe Eficiencë e Energjisë).
- b) **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike** (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).
- c) **Fakulteti i Edukimit** (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Teknologji me TIK)
- d) **Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike** (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).
- e) **Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë** (Veterinari, Agroekonomi, Bioteknologji, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Bioteknologji Ushqimore).
Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).
- f) **Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore** (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Shkenca Kompjuterike)
- g) **Fakulteti i Arteve**
- h) **Fakulteti Filologjik** (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).

Dokumentet e nevojshme për aplikim;

- a) Çertifikata e notave (**me vulë origjinale**)
- b) Vërtetimi i semestrit se studenti ka regjistruar vitin akademik 2025/2026 (**me vulë origjinale**);
- c) Fotokopje ID apo indeksin (fotografin, semestrat dhe notat);
- d) Deklarata e bashkësisë familjare;
- e) Çertifikatën e vendbanimit;
- f) Dëshmia se është; fëmijë i dëshmorit, invalid i luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale;
- g) Diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara shtetërore dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe çertifikatë për punë vullnetare;
- h) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultet, (prioritet fakultetet me drejtime deficitare).
- i) Kopjen e letërnjoftimit dhe
- j) Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale);

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit (kati i parë) nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.

Afati për aplikim është **15 ditë** prej datës **10.02.2026** deri më datën **24.02.2026**

Sqarim shtesë: Për bursë kanë **prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores Nr. 01/ 8214/ 2024 do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**

Vërejtje: Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të thirrjes, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

Drejtor i Arsimit
Hisni Luri

